

V E N D I M
Nr.544, datë 5.8.1996

PËR KRIJIMIN E KOMITETIT KOMBËTAR PËR POPULLSINË

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vartësi të Këshillit të Ministrave, krijohet Komiteti Kombëtar për Popullsinë pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

2. Detyrat e Komitetit Kombëtar për Popullsinë do të jenë:

2.1. Formulimi i një Dokumenti të Politikës mbi Popullsinë dhe Zhvillimit në Shqipëri në përputhje me ndryshimet aktuale në vendin tonë dhe me zhvillimin perspektiv të shoqërisë shqiptare.

2.2. Hartimi i një programi afatgjatë për vënien në jetë të kësaj politike shtetërore lidhur me zhvillimin e popullsisë në Shqipëri.

2.3. Sugjerimi i alternativave për koordinimin e politikave demografike, sociale, ekonomike dhe të të gjitha fushave të tjera në bashkëpunim me ministrinë e interesuara.

3. Përbërja e Komitetit Kombëtar për Popullsinë është si më poshtë:

1. Ylli Vejsiu, zv. kryetari i Akademisë së Shkencave, kryetar.

2. Sekretar Shteti për Rininë dhe Gruan në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Gruas.

3. Zv.ministër i Shëndetësisë dhe Ambientit

4. Zv.ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale

5. Zv.ministër i Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore

6. Zv.ministër i Drejtësisë

7. Drejtor i Institutit të Statistikës

8. Suzana Lame, eksperte e demografisë

9. Vladimir Misja, ekspert i demografisë

4. Kryetari i Komitetit Kombëtar për Popullsinë është nomenklaturë e përhershme e Kryeministrit.

5. Ky Komitet ngarkohet të paraqesë brenda muajit të formimit rregulloren e brendshme të tij. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi